

**VENDIM**  
**Nr. 482, datë 30.7.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 164, DATË 19.2.2020, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË  
NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE CAKTIMIN E  
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” e “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 164, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
  - a) Në pikën 1, harta dhe koordinatat zëvendësohen përkatësisht me hartën dhe koordinatat, që i bashkëlidhen këtij vendimi;
  - b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“2. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për këtë zonë, për ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike e kritike.”.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

**BASHKIA DURRES, ZONA E RE PER ZHVILLIM “SPITALLE”**



**LEGJENDE SHPJEGJEUSE**

- Zona e Re për Zhvillim
- Zona për Rindërtim

**Koordinatat e  
Zonës së Re për Zhvillim;**

Pika	X_Koord	Y_Koord
1	371536.4	4577235
2	370976.3	4578298
3	372345.7	4579022
4	372449.4	4579020
5	372980.9	4578007
6	371536.4	4577235
7	369750.2	4577742
8	370461.5	4576662